VENDIM
Nr.895, datë 26.11.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.64, DATË 29.1.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE, GJATË VITIT 2004"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.64, datë 29.1.2004 të Këshillit të Ministrave në tabelën "Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2004, Ministria e Drejtësisë", të bëhen ndryshimet sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

OBJEKTIVA TË RISHIKUARA
PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2004
(VENDIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.64, DATË 29.1.2004)

Nr.	Projektakti	Afati i programuar për paraqitjen në Këshillin e Ministrave (Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.64, datë 29.1.2004)	Afati i rishikuar për paraqitjen në Këshillin e Ministrave	Komente të lidhura me paraqitjen e projektit në Këshillin e Ministrave
7	Projektligj për përgjegjësinë penale të personave juridikë	Maj	Dhjetor	Vonesa për mendimet e kërkuara: M.Financave P.Përgjithshme
10	Projektligje lidhur me përdorimin e kamerave në vende publike dhe private për efekt të sigurisë publike dhe ndjekjes penale	Nëntor	Dhjetor	Bashkërendimi me P.Përgjithshme M.R.Publik M.Financave M.Integrimit
11	Projektligj për bashkëpunimin gjyqësor dhe ligjor ndërkombëtar	Korrik	Qershor 2005	Bashkërendimi me P.Përgjithshëm M.P.Jashtme M.Financave M.R.Publik M.Integrimit
13	Paketa ligjore për drejtësinë e të miturve me shtesa	Nëntor	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e drejtësisë dhe

	dhe ndryshime në legjislacionin penal etj., si dhe në organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë			asistencën e huaj të programuar
14	Projektligj për kompensimin për burgim të padrejtë	Tetor	Dhjetor	Bashkërendimi me M.Financave M.Integrimit P.Përgjithshme
15	Projektligj kundër zvarritjeve në procesin hetimor dhe gjyqësor, si dhe përgjegjësisë përkatëse ndaj të tretëve	Tetor	Shtator 2005	Bashkërendimi me organet gjyqësore KLD P.Përgjithshëm M.Financave M.Integrimit
16	Projektligj për faljet dhe amnistinë	Gusht	Dhjetor	
17	Projektligj për ratifikimin e Konventës së OKB për korrupsionin	Maj	Dhjetor 2005	Në varësi të zhvillimeve ndërkombëtare dhe rishikimit të brendshëm
21	Projektligje për ratifikimin e protokolleve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Protokolli i 13-të)	Shkurt	Dhjetor 2005	Në varësi të zhvillimeve ndërkombëtare dhe rishikimit të brendshëm
23	Projektligj për ndryshime në ligjin për shoqëritë tregtare	Gusht	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
24	Projektligj për ndryshime në ligjin për regjistrin tregtar	Gusht	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
25	Projektligj për shfuqizimin e pjesës së parë të Kodit Tregtar	Gusht	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
26	Projektligj për të drejtën ndërkombëtare private	Nëntor	Qershor 2005	Bashkërendimi me organet gjyqësore M.P.Jashtme M.Integrimit

28	Projektligj për shtesa dhe ndryshime në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor	Tetor	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
29	Projektligj për vlerësimin profesional të gjyqtarëve	Tetor	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
30	Projektligj për ndryshime në ligjin për shkollën e Magjistraturës	Korrik	Dhjetor	
34	Projektakte nënligjore për funksionimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare	Mars	Dhjetor	
36	Projektligj për arbitrazhin	Maj	Dhjetor	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
38	Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Drejtësisë	Prill	Qershor 2005	Në varësi të unifikimit të hartimit të këtyre akteve në sistemin e qeverisjes